

UDHËZIM
Nr.13, datë 26.5.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10 343, datë 28.10.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat””, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në deklaratën individuale vjetore për individët e huaj, te pjesa “Për mënyrën e plotësimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të individëve të huaj në Republikën e Shqipërisë, pika 23 ndryshohet, me përmbajtjen:

“23. Tatimi mbi pagën plotësohet për shumën e tatimit mbi pagën dhe shpërblimet mbi pagën të paguar gjatë periudhës tatimore. Në rastin e të vetëpunësuarit që kryen veprimtari të biznesit të vogël, kjo kuti plotësohet me shumën e tatimit të paguar nga zhvillimi i kësaj veprimtarie (kutia nr.22 e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël).”

Ku udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode